**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA SHIJAK**
**DREJTORIA EKONOMIKE**

# PROJEKT - VENDIM

## MONITORIMI I BUXHETIT PËR

## PERIUDHËN :

## JANAR – DHJETOR 2020

Monitorimi i zbatimit te buxhetit per periudhen Janar –Dhjetor 2020 eshte bere duke u mbeshtetur ne Ligjin 68 date 24/04/2017 “Per Financat e Veteqeverisjes Vendore”, Ligjin 139/2015 “Per Veteqeverisjen Vendore” ne Ligjin 57/2016 “Per disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, te ndryshuar,“ Udhezimin Plotesues te Ministrise se Financave nr 2 date 20.01.2020 “Per Zbatimin e Buxhetit te Vitit 2020 “ ne VKB nr 27 date 25.11.2019 mbi “Miratimin e Paketes Fiskale per Vitin 2020 “,ne Udhezimin nr 9 te Ministrise se Financave date 20/03/2018 “Per Procedurat Standarte te Zbatimi te Buxhetit “,dhe te Udhezimit plotesues te Ministrise se Financave nr 4 date 24/01/2021 “ Per Zbatimin e Buxhetit te vitit 2021 “,si dhe ne te dhenat e pasqyrave dhe Aktet e Rakordimit me Degen e Thesarit Durres per te dhenat e vitit 2020 drejtoria ekonomike paraqet relacionin mbi monitorimin e buxhetit per periudhen Janar –Dhjetor te vitit 2020 te Bashkise Shijak,

## ANALIZE E REALIZIMIT TE TE ARDHURAVE LOKALE

Te ardhurat Lokale për Bashkinë Shijak në vitin 2020 jane realizuar ne masen 70 % dhe ne vleren 156.174 mije leke , me nje difernece ne minus 67,024 mije leke . Në tabelën e mëposhtëme pasqyrohet realizimi i të ardhurave te detajuara sipas llojit te tyre :

| Nr | EMERTIMI | Plani 2019 | Fakti 2019 | % realiz | Plani 2020 | Fakti 2020 | % realiz | Diferenca |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | |
| **A.** | **TE ARDHURA TATIMORE** | **161,373** | **130,292** | **81** | **160,068** | **110,298** | **69** | **(49,770)** |
| **I** | **Taksa mbi Pasurine e Paluajtshme** | 69,552 | 46,395 | 67 | **70,553** | **58,222** | 83 | (12,331) |
| a. | Taksa mbi Ndertesen | 47,716 | 40,044 | 84 | 48,717 | 43,724 | 90 | (4,993) |
| | Biznesi | 30,858 | 32,017 | 104 | 31587 | 27,137 | 86 | (4,450) |
| | Popullsia | 16,858 | 8,027 | 48 | 17,130 | 16,587 | 97 | (543) |
| b. | Taksa mbi Token Bujqesore | 21,836 | 6,351 | 29 | 21,836 | 14,498 | 66 | (7,338) |
| **II** | **Taksa Vendore Biznesi I Vogel** | 6,300 | 2,521 | 40 | 3,120 | 2,969 | 95 | (151) |
| **III** | **Te ardhura te tjera vendore** | 70,631 | 61,002 | 86 | 70,273 | 24,554 | 35 | (45,719) |
| b. | Taksa e Ndikimit ne Infrase per Ndertesat e reja | 65,549 | 55,518 | 85 | 64,937 | 19,449 | 30 | (45,488) |
| c. | Taksa e Truallit | 5,082 | 5,484 | 108 | 5,336 | 5,105 | 96 | (231) |
| **IV** | **Taksa te administruara nga agjente tatimore** | 11,690 | 16,137 | 138 | 12,705 | 19,371 | 152 | 6,666 |
| a. | Taksa per Kalimin e Pasurise se Paluajtshme | 1,400 | 4,652 | 332 | 1,470 | 1,145 | 78 | (325) |
| b. | Taksa e mjeteve te perdoruara | 10,290 | 11,485 | 112 | 11,235 | 18,226 | 162 | 6,991 |
| **V** | **Taksa e Tabeles** | 3,200 | 4,237 | 132 | 3,360 | 5,086 | 151 | 1,726 |
| a. | per qellime identifikimi | 200 | 60 | 30 | 220 | 340 | 155 | 120 |
| b. | per qellime Reklamimi | 3,000 | 4,177 | 139 | 3,140 | 4,746 | 151 | 1,606 |
| **VI** | **Te ardhura nga Renta minerare** | | | | 57 | **96** | 168 | 39 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **B.** | **TE ARDHURA JOTATIMORE** | **45,202** | **25,462** | 56 | **46,833** | **40,009** | **85** | **(6,824)** |
| I | Te ardhurat nga tarifat | 45,202 | 25,462 | 56 | 46,833 | | - | (46,833) |
| 1 | Tarife e Pastrimit dhe e Ndricimit | 28,946 | 13,302 | 46 | 31,282 | 20,676 | 66 | (10,606) |
| | Biznesi | 15,440 | 10,704 | 69 | 16520 | 10,252 | 62 | (6,268) |
| | Popullsia | 13,506 | 2,598 | 19 | 14,762 | 10,424 | 71 | (4,338) |
| 2 | Tarife e Ndricimit | 2,336 | 959 | 41 | 0 | - | | - |
| | Biznesi | 1,040 | 707 | 68 | 0 | - | | - |
| | Popullsia | 1,296 | 252 | 19 | 0 | - | | - |
| 4 | Tarifa per Sherbime Veterinare | - | | | 0 | - | | - |
| 5 | Tarifa e Sherbimit te transportit | 3,000 | 2,659 | 89 | 3,150 | 2,343 | 74 | (807) |
| 6 | Tarifa eParkimit | 50 | 67 | 134 | 53 | 69 | 130 | 16 |
| 7 | Tarifa pervertetime,autorizime etj | 600 | 568 | 95 | 500 | 603 | 121 | 103 |
| 8 | Tarifa te sekt te bujqesise e pyjeve | 1,000 | 1,077 | 108 | 1300 | 1,091 | 84 | (209) |
| 9 | Tarife sherbimi nga instit arsim kulture sport | 210 | 130 | 62 | 210 | 42 | 20 | (168) |
| 10 | Tarife per sherbime MZSH | 500 | 812 | 162 | 900 | 494 | 55 | (406) |
| 11 | Tarifa e tregut te lire | 530 | 501 | 95 | 557 | 82 | 15 | (475) |
| 12 | Tarife per zenie hapsire publike | 30 | | 0 | 32 | - | - | (32) |
| 15 | Tarifa e drejtorise kont dhe zhvill teritorit | 8,000 | 5,387 | 67 | 8,849 | 14,609 | 165 | 5,760 |
| | | | | | | | | |
| **C.** | **TE ARDHURA TE TJERA** | **12,355** | **9,117** | 74 | **16,297** | **5,867** | 36 | (10,430) |
| **I** | **Te ardhura nga institucionet** | 1,800 | 1,214 | 67 | 1,890 | 989 | 52 | (901) |
| a. | Te Ardhura Kopeshte Cerdhe | 1,800 | 1,214 | 67 | 1,890 | 989 | 52 | (901) |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| II | **Te ardhura te tjera** | 10,555 | 7,903 | 75 | 14,407 | 4,878 | 34 | (9,529) |
| 1 | Detyrime te pambledhura | 10,000 | 6,100 | 61 | 13,850 | 4,546 | 33 | (9,304) |
| 2 | Gjoba nga mosshlyerja ne afat e detyrimeve | 55 | 139 | 253 | 200 | 32 | 16 | (168) |
| 3 | Gjoba per shkeljet administrative | 500 | 1,664 | 333 | 357 | 300 | 84 | (57) |
| | **TOTALI** | **218,930** | **164,871** | 75 | **223,198** | **156,174** | 70 | (67,024) |

Po te bejme krahasimin me vitin e kaluar ne total te ardhurat jane realizuar 5 % me pak dhe ne vlere ato jane 8,697 mije leke me pak se viti 2019.(164,871-156,174)

Ne pergjithsi mund te themi se kryesisht ka ndikuar pandemia dhe situata pas termetit te 26 nentorit te vitit 2019, efeket e te cilave sic parashikohet do te ndikojne edhe ne vitin ne vazhdim.

Me poshte po bejme analizen e te ardhurave qe zene peshen specifike me te madhe ne te ardhurat e Bashkise:

1.<u>Taksa mbi Ndërtesën</u> : Planifikimi i taksës së ndërtesës për periudhën Janar – Dhjetor 2020 në total ka qene 48,717mije leke, dhe ne fakt eshte realizuar 43,724 mije leke pra 90 % me nje diference 4,993 mije leke .Kjo takse realizohet nga dy kategori :

| Burimi i te Ardhures | Taksë mbi Ndërtesën | | | Viti 2020 | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Fakti 2019 | Plan | Fakt | % Realizimit | Diferenca |
| Biznesi | 32,017 | 31,587 | 27,137 | 86 | 4,450 |
| Popullsia | 8,027 | 17,130 | 16,587 | 97 | 543 |
| Totali | 40,044 | 48,717 | 43,724 | 90 | 4,993 |

Sic shihet kjo takse per kategorine e popullsise ka patur dyfishim te faktit ne krahasim me vitin e kaluar , duke konstatuar keshtu nje ndergjegjesim te popullates edhe pse ne keto kushte , pervecse realizim vjetor ka patur edhe zbutje te detyrimeve te viteve te kaluara te cilat sic dihet mbarten vit pas viti.

Vetem kete vit keto detyrime jane zbutur per shifren 4,546 mije leke dhe kjo e gjitha per kategorine e popullsise , ndersa biznesi ne fund vit rezulton me nje detyrim te pambledhur per 4,450 mije leke per taksen e nderteses dhe 6,268 mije leke per tarifen e pastrimit dhe ndricimit.

Paraqitja grafike e takses se nderteses




Nje nga arsyet per mosrealizimin e te ardhurave nga taksa e nderteses dhe ne pergjithesi nga taksat dhe tarifat vendore eshte edhe veshtiresite qe u hasen ne te gjithe sektoret nga pandemia,duke krijuar veshtiresi ne pagesa.Sektori I taksave po punon për përmirsimin e bazës së të dhënave mbi ndërtesat mbështetur në metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurise së paluajtshme "Ndërtesa" .Sektori I taksave bën çdo muaj rakordimin e të ardhurave nga taksa e ndërteses me 3 - njësitë administrative .

2.<u>Taksa mbi Tokën Buqësore</u> :

| Burimi i te Ardhures | Taksa mbi Tokën Buqësore | | | Viti 2020 | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Fakti 2019 | Plan | Fakt | % Realizimit | Diferenca |
| Totali | 6,351 | 21,836 | 14,498 | 66 | -7,338 |

Realizimi i të ardhurave nga kjo taksë është në masën 66 %.Duke e krahasuar me vitin 2019 kjo takse eshte realizuar nga 29 % ne 66 % ose 8,147 mije leke me shume , duke konstatuar keshtu nje ndergjegjesim te popullates edhe pse ne keto kushte ashtu si dhe per taksat e tjera ku rezultojme me teper se viti 2019.
Taksa mblidhet nga inspektorët e taksave pranë njësive administrative Xhafzotaj ,Maminas,Gjepale. Megjithe vështirësite në mbledhjen e taksës së tokës buqësore për shkak të aftësisë së pakët paguese që kanë banorët e fshatrave të njësive administrative

do te punohet  vazhdimisht qe te vazhdojme ne rritje  te realizimit te treguesve financiare.Sektori I taksave bën cdo muaj rakordimin e të ardhurave nga taksa e tokës buqësore  me njësitë  administrative .




3.<u>Taksa Vendore Biznesi i Vogel</u> :

| Burimi i te Ardhures | <u>Taksa Vendore Biznesi i Vogel</u> | | | Viti 2020 | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Fakti/ 2019 | Plan | Fakt | % Realizimit | Diferenca |
| Totali | 2,521 | 3,120 | 2,969 | 95 | -151 |

Realizimi I kesaj takse  eshte ne masen 95 % per vitin 2020 dhe ne krahasim me vitin 2019 kemi 448 mije  leke me shume.



Agjenti tatimor për mbledhjen e taksës vendore të biznesit të vogel ështe Drejtoria e Tatim Taksave Durrës. Sektori i taksave bën cdo muaj rakordimin me këtë drejtori lidhur me të ardhurat e gjeneruara nga kjo taksë.

4. Taksa e ndikimit në Infrastrukturë :

Realizimi i të ardhurave nga taksa e Infrastrukturës shkon në masën 29.95 %.

| Burimi i te Ardhures | Taksa e ndikimit në Infrastrukturë | | | Viti 2020 | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Fakti/ 2019 | Plan | Fakt | % Realizimit | Diferenca |
| Totali | 55,518 | 64,937 | 19,449 | 30 | - 45,488 |

Sic shihet kjo takse eshte realizuar ne masen 30 % dhe ne vlere -45,488 mije leke , ky mosrealizim ka ardhur nga mungesa e dhenieve te lejeve te ndertimit me pagese pas ndryshimeve ligjore per faljen e detyrimeve per ndertimet pasi te gjitha ishin rindertime nga termeti,sic shihet vetem kjo takse perben 67 % te totalit te mosrealizimit te te ardhurave (45,488/67,024).




Taksa e ndikimit në infrastrukturë mblidhet nga Drejtoria e Urbanistikës në momentin e aplikimit për leje. Planifikimi i të ardhurave nga kjo taksë është bërë duke marë parasysh realizimin e të ardhurave nga taksa të vitit paraardhës.

5.Taksa e truallit :

Të ardhurat e taksës së truallit shkon në masën 96 %.

| Burimi i te Ardhures | Taksa e truallit | | | Viti 2020 | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Fakti/ 2019 | Plan | Fakt | % Realizimit | Diferenca |
| Totali | 5,484 | 5,336 | 5,105 | 96 | -231 |

Të dhenat për trojet janë në permiresim të përditshëm pasi kjo takse u fut për herë të parë në vitin 2017 me ligj ,pasi nuk kemi të dhëna nga ZRPP Durrës megjithë kërkesat tona drejtuar këtij institucioni ,kështu edhe planifikimi është bëre në mënyrë të përafërt.




6.Taksa e Regjistrimit të Përvitshëm të Mjeteve të Përdorura :

Realizimi i kësaj të ardhure është 162 %.

| Burimi i te Ardhures | Taksa e Regjistrimit të Përvitshëm të Mjeteve të Përdorura | | | Viti 2020 | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Fakti/ 2019 | Plan | Fakt | % Realizimit | Diferenca |
| Totali | 11,485 | 11,235 | 18,226 | 162 | 6,991 |




Agjenti tatimor për mbjedhjen e taksës së mjeteve të përdorura është DSHA Durres.Sektori i taksave bën rakordime periodike me këte drejtori për sa i përket të ardhurave të mbledhura nga kjo taksë.

7.<u>Taksa e tabelës</u> : Të ardhurat nga kjo taksë paraqiten si më poshtë:

Realizimi i të ardhurave nga taksa e tabelës për qëllime identifikimi shkon në masën 151 %.Tabela për qëllime reklamimi dhe identifikimi ne total :

| Burimi i te Ardhures | Taksa e tabelës | | | Viti 2020 | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Fakti/ 2019 | Plan | Fakt | % Realizimit | Diferenca |
| Totali | 4,237 | 3,360 | 5,086 | 151 | 1,726 |



8.Tarifa e Sherbimeve (Pastrimit dhe Ndricimit): Planifikimi i tarifës së sherbimeve per vitin 2020 ka qenë në total 31,282 mije lekee ndare ne dy kategori :

| Burimi i te Ardhures | Tarifa e Pastrimit dhe e Gjelbërimit | | | Viti 2020 | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Fakti 2019 | Plan | Fakt | % Realizimit | Diferenca |
| Biznesi | 10,530 | 15,440 | 10,704 | 69 | -4,736 |
| Popullsia | 4,022 | 13,506 | 2,598 | 19 | -10,908 |
| Totali | 14,552 | 28,946 | 13,302 | 46 | -15,644 |

E shprehur në përqindje totali realizimit i tarifës së pastrimit dhe gjelbërimit (Biznes + Popullsi) është në masën 46 %, ku 69 % e përbën Biznesi dhe 19 % Popullsia. Deficitin me te madh ne kete tarife e ze popullsia – 10,908 mije leke pasi sic e permendem me siper ne taksen e nderteses ku popullsia kishte tregues shume te permiresuar ne tarifen e pastrimit kemi pagesa per vitet e kaluara dhe saktesojme se ajo eshte 4,546 mije leke gje qe do te thote se saktesisht per kete tarife eshte mbledhur 7,144 (2,598+4,546) Sic shihet nga të dhënat e mësipërme mosrealizimi I kësaj tarife, vjen si rezultat i faktorëve social dhe ekonomike si dhe per shkak te pandemise.Nga ana e sektorit të taksave janë dërguar njoftim detyrimet për cdo familje . Në përmirësimin e mbledhjes së të ardhurave nga tarifa e pastrimit dhe ndricimit do të ndikoje futja e detyrimeve në faturen e ujit ,në momentin e kalimit të ujesjellës kanalizime në administrimin e bashkisë.



9.Tarifa e Drejtorisë së Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit :

Realizimi i të ardhurave nga Tarifat e Drejtorisë së Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit shkon në masën 165 %. Këto tarifa paguhen në momentin e marrjes së lejeve dhe sherbimeve të ndryshme nga Sektori i Urbanistikës. Planifikimi i këtyre tarifave bëhet duke marë parasysh realizimin e vitit paraardhës dhe aplikimet për leje të ndryshme.

| Burimi i te Ardhures | Tarifa e Drejtorisë së Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit | | | Viti 2020 | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Fakti/ 2019 | Plan | Fakt | % Realizimit | Diferenca |
| Totali | 5,387 | 8,849 | 14,609 | 165 | 5,760 |

Kjo lloj tarife per realizimin faktik te saj ze 9.3 % te te ardhurave te vitit 14,609/156,174 ) dhe realizimi me 165 % te saj ndikon ne zbutjen e deficitit total te realizimit te te ardhurave .




10.Tarifa për Dhënie Leje Transporti :

Tarifa për dhënien e lejeve të transportit lëshohet nga Sektori I Shërbimeve.Planifikimi i këtyre tarifave bëhet duke marë parasysh realizimin e vitit paraardhës dhe aplikimet për leje të ndryshme.

| Burimi i te Ardhures | Tarifa për Dhënie Leje Transporti | | | Viti 2020 | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Fakti/ 2019 | Plan | Fakt | % Realizimit | Diferenca |
| Totali | 2,659 | 3,150 | 2,343 | 74 | -807 |




Realizimi i të ardhurave nga tarifa e lejeve të transportit shkon në masën 74 % ose ne vlere -807 mije leke.

11. Të ardhurat nga Kopeshti + Cerdhja :

Realizimi i të ardhurave nga tarifat e Kopështit + Cerdhes janë 52.33 %.

| Burimi i te Ardhures | Të ardhurat nga Kopeshti + Cerdhja | | | Viti 2020 | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Fakti/ 2019 | Plan | Fakt | % Realizimit | Diferenca |
| Totali | 1,214 | 1,890 | 989 | 52 | -901 |

Realizimi i kesaj tarife ne kete mase shkon paralelisht me faktin e mbylljes se kopeshteve dhe cerdhes gjate periudhes se pandemise.




12. <u>Tarifë për Shërbime MZSH</u>:

Realizimi i të ardhurave nga Tarifat për Shërbimin e MZSH janë në masën 54.9%.Këto tarifa administrohen nga Sektori i MZSH:

| Burimi i te Ardhures | Tarifë për Shërbime MZSH | | | Viti 2020 | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Fakti/ 2019 | Plan | Fakt | % Realizimit | Diferenca |
| Totali | 812 | 900 | 494 | 55 | -406 |



Në territorin e Bashkisë Shijak për vitin 2020 ushtruan aktivitet 881 subjekte nga të cilat 262 subjekte Biznes i Madh dhe 619 subjekte biznes i vogël.

Kanë shlyer detyrimet 337 subjekte nga të cilat 127 biznesi i madh dhe 210 biznesi i vogël.

Të ndarë sipas njësive administrative nr. i bizneseve paraqitet në tabelën e mëposhtëme:

| | | Nj.A.Shijak | Nj.A.Xhafz | Nj.A.Mamin | Nj.A.Gjep | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | **Biznesi i Madh** | 38 | 175 | 45 | 4 | **262** |
| | Paguar | 18 | 83 | 26 | 0 | **127** |
| | Papaguar | 20 | 92 | 19 | 4 | **135** |
| 2 | **Biznesi i vogel** | 212 | 273 | 108 | 26 | **619** |
| | Paguar | 54 | 114 | 40 | 2 | **210** |
| | Papaguar | 158 | 159 | 68 | 24 | **409** |




Gjatë periudhës Janar –Dhjetor 2020 kanë pezulluar aktivitetin 23 subjekte dhe te 23 subjektet jane biznesi i vogel, dhe efekti financiar ne mbylljen e ketyre bizneseve shkon ne 322 mije leke.

**Produktet për vitin 2020**

Bashkia Shijak per vitin 2020 i ka realizuar funksionet e saj duke u mbeshtetur ne 21 programe realizimi i te cilave perkon me keto te dhena financiare:

## ANEKSI nr.1 "Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve"

ne 000/leke

| Emri i Grupit | | | | | | Kodi i Grupit | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Programet | | Shpenzimet e Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore | | | | | | | Realizimi ne % |
| | | (1) | (2) | (3) | (4) | (5) | (6) | (7)=(6)-(5) | |
| | | Fakti | PBA | Buxheti Vjetor | Buxheti Vjetor | Buxheti Vjetor | Fakti | Diferenca | |
| Titulli | Emertimi | i vitit paraardhes Viti 2019 | Viti 2020 | Plan Fillestar Viti 2020 | Plan i Rishikuar Viti 2020 | Plani i Periudhes /progresiv | i Periudhes /progresiv | | |
| 011 | Organet ekzekutive dhe legjislative,Ceshtjet financire | 69,873 | 249,994 | 273,416 | 7,546 | 84,087 | 73,231 | (10,856) | 87 |
| 013 | Sherbime te pergjith auditi + gj.civ | 5,975 | 5,300 | 5,300 | 1,826 | 6,376 | 6,315 | (61) | 99 |
| 031 | Sherbime e Policise | 7,675 | 6,222 | 6,222 | | 5,333 | 4,893 | (440) | 92 |
| 032 | Sherbimet e mbrojtjes nga zjarri | 10,920 | 14,861 | 14,861 | 1,473 | 15,367 | 13,779 | (1,588) | 90 |
| 041 | Ceshtjet e pergjithshme ekonomike, treg punes | 3,968 | 4,113 | 4,113 | | 3,773 | 3,673 | (100) | 97 |
| 042 | Bujqesia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia | 48,165 | 20,981 | 21,181 | 45,708 | 65,783 | 55,745 | (10,038) | 85 |
| 045 | Trasporti ndertim dhe mirembajtje rrugesh | 33,692 | 162,266 | 162,266 | 3,891 | 42,455 | 36,276 | (6,179) | 85 |
| 047 | Emergjence termeti grant/bonuse | | | | 1,322,584 | 1,322,584 | 965,581 | (357,003) | 73 |
| 051 | Menaxhimi I mbetjeve | 43,236 | 41,393 | 41,394 | 16,420 | 48,196 | 30,429 | (17,767) | 63 |
| 052 | Menaxhimi I ujerave te zeza | 4,400 | 21,605 | 21,605 | 14,624 | 28,324 | 27,685 | (639) | 98 |
| 061 | Planif Urban Vendor | 8,070 | | | | - | | - | |
| 062 | Sherbimet publike vendore | 27,325 | 22,820 | 22,820 | 9,646 | 34,644 | 32,858 | (1,786) | 95 |
| 063 | Furnizimi me uje | 1,730 | 5,909 | 5,909 | | 84,012 | 76,011 | (8,001) | 90 |
| 064 | Ndricimi I rrugeve | 10,560 | 30,000 | 30,000 | | 11,500 | 8,987 | (2,513) | 78 |
| 081 | Sherbimet Rekreative dhe sportive | 26,822 | 29,202 | 29,202 | 3,000 | 29,175 | 21,464 | (7,711) | 74 |
| 082 | Sherbime kulturire | 2,939 | 4,197 | 4,197 | | 4,050 | 2,828 | (1,222) | 70 |
| 091 | Arsimi baze dhe parashkollor | 130,706 | 130,203 | 130,203 | 3,415 | 119,745 | 97,937 | (21,808) | 82 |
| 092 | Arsimi I mesem | 2,923 | 2,923 | 2,923 | | 2,923 | 2,923 | - | 100 |
| 101 | Semundje dhe paaftesi | 171,147 | 176,900 | 186,000 | | 187,778 | 186,795 | (983) | 99 |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **104** | Familja dhe femijet | 5,940 | 7,130 | 7,130 | | 6,541 | 6,164 | (377) | 94 |
| **105** | Ndihma ekonomike | 5,256 | 15,194 | 6,093 | | 5,471 | 5,180 | (291) | 95 |
| **106** | Strehim Social | 1,260 | 1,440 | 1,440 | | 1,360 | 900 | (460) | 66 |
| **Totali i Shpenzimeve të Njësisë** | | **622,582** | **952,653** | **976,275** | **1,430,133** | **2,109,477** | **1,659,654** | **(449,363)** | 79 |
| **Totali i Shpenzimeve pa gr e Rindertimit** | | | | | | 786,893 | 694,073 | (92,360) | 88 |

Sic shihet nga aneksi nr 1 shpenzimet ne total jane realizuar ne masen 79 % me nje diferenca 449,363 mije leke tregon shumen e shpenzimeve te parealizuara per vitin 2020, ne kete shume perfshihet edhe shuma prej 357,003 mije leke qe jane grantet e rindertimit te pa shperndare ne daten 31.12.2020 pra diferenca "reale " ndaj totalit eshte 92,360 mije leke qe tregon shumen e shpenzimeve te parealizuara per bashkine shijak dhe e shprehur ne % eshte 88 %.

Programi 01110 " Organet ekzekutive dhe legjislative,Ceshtjet financiare "

Ky program perfshin organizimin e Administratës së Bashkisë së Shijak në funksion të përmbushjes së misionit,qëllimeve, objektivave dhe përgjegjësive të Bashkisë së Shijak për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.
Kemi synuar sigurimin e mbështetjes së funksionimit të Administatës së Bashkisë Shijak përmes
realizimit në kohë të shpenzimeve për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore. Mbështetje e
strukturës funksionale me 214 punonjës me kohe te plote dhe 10 punonjes me kohe te pjeseshme.
Plotesim sipas nevojës dhe rekrutimi I personelit të administratës vendore në mënyrë transparente, me profesionalizëm dhe në bazë të meritave, aftësive profesionale, pavarësisë dhe integritetit, vazhdimësisë së karrierës, përgjegjësisë dhe korrektesës në zbatimin e ligjeve:

Zbatimi i buxhetit për shpenzime personeli u bazua tek numri i punonjësve dhe nivelet e pagave sipas klasave e shtesave mbi pagë në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, brenda kufirit minimal dhe maksimal të miratuar. Paga, shtesat mbi pagat e punonjësve bëhen sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.165 datë 02.03.2016 "Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, VKM nr. 717, date 23.6.2009, të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore" të ndryshuar;
Numri i aplikuesve për vendet e shpallura ishte rreth 8 aplikues.
Këto rekrutime janë realizuar me procedurë,nderkohe kemi patur 2 lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë 2 për kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese dhe pranimit në 8

shërbimin civil për kategorinë ekzekutive. Kjo procedurë është realizuar përmes konkursit të hapur në zbatim të Ligjit Nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar,
VKM Nr. 242, datë 18/03/2015, VKM Nr. 243, datë 18/03/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele,
periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”. Konkurimi ka ndjekur disa etapa, përfshirë ngritjen e Komisioneve të pranimit. Anëtarë të komisioneve të vlerësimit gjatë procesit të rekrutimit kane qenë punonjës të nivelit drejtues të administratës publike vendore si dhe ekspertë jashtë institucionit të Bashkisë Shijak.

**Trajnimi i burimeve njerëzore të Bashkisë së Shijak**

Ky aktivitet synonte që nëpunësit civilë për përfitimin dhe përditësimin e njohurive shtesë të mund të kryenin trajnime në institucione të tjera trajnuese me inisiativën e tyre, për detyrën që ata kryejnë, me propozimin e përbashkët të eprorit e të drejtuesit të njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit dhe me miratimin e titullarit të institucionit. Gjatë vitit 2020 janë zhvilluar 21 per trajnime për 21 punonjes , kete vit nr i ketyre trajnimeve per shkak te pandemise eshte shume i vogele ne krahasim me vitet e kaluara. Këto trajnime janë realizuar me mbështetjen e Bashkisë Shijak dhe të donatorëve, organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore përgjegjëse.

**Mbështetja dhe ofrimi i shërbimeve bazë** për funksionimin e administratës së Bashkisë
Është përmirësuar funksionimi normal i të gjithë administratës së Bashkisë së Shijak nëpërmjet ofrimit të shërbimeve mbështetëse bazë si ujë, energji elektrike, ngrohje, komunikim postar, shërbim telefonie, interneti etj.

Programi 01110 “ Organet ekzekutive dhe legjislative,Ceshtjet financiare “eshte realizuar ne masen 87 % ose - 10,856 mije leke dhe ketu vetem mosrealizimi I zerit te sherbimeve te tjera eshte ne mase 76 % ose ne vlere 7,294 mije leke mije leke shpenzime operative te parealizuara sic jane fatura te ndryshme apo kontrata te pa mbylluara te cilat jane planifikuar per pagese ne vitin 2021 me te ardhurat te trasheguara.
Zeri I shpenzimeve ( 604 ) “Transferta korente te brendshme” eshte realizuar 59 % te fondit te planifikuar per emergjenca civile ,pra diferenca 2,620 mije leke eshte emergjence civile e pa perdorur .Bejme me dije se gjate vitit 2020 ne magazine e bashkise shijak kane ardhur 3,023 mije leke furnizime falas, ketu mund te vecojme 2 konteniere me vlere 450 mije leke per tu perdorur per banim per familjet e demtuara nga termeti aktualisht jane te magazinuara ne depot e emergjencave civile , dhe diferenca jane ushqime ardhur nga rezervat e shtetit., materiale pastrimi dezinfektante etj gje qe ka bere qe fondi yne I planifikuar te mos ezaurohet i gjithi.
Nga fondi I bashkise ne fakt jane shpenzuar 3,765 mije leke ku jane perballuar emergjenca te tilla si blerja ushqimesh per pergatitje te pakove ushqimore per 1250 familjet ne nevoje per shumen 1361 mije leke kryesisht per Njesite Administrative Gjepalaj, Maminas dhe Xhafzotaj, blerje materiale dezinfektimi, maska, doreza per 858 mije leke , marrje ambientesh me qera per magazinim 620 mije leke , transport te 2 personave te semure gjate pandemise te cilet kishin nevoje per terapi te perditshme per nje periudhe 2.5 muaj per shumen 312 mije leke,pagese energji elektrike per hotelet ku jane sistemuar te demtuarit nga termeti 200 mije leke etj.Emergjencat Civile kane qene ne

gadishmeri te plote gjithe vitin, per te perballuar me se miri ngjarjet e renda si termeti i dates 26 Nentor te vitit 2019 , dhe problemet e pandemise se Covid 19 qe ishte nje sprove e madhe per administraten e Bashkise tone te cilen e perballuam dhe vazhdojme te permballojme ngarkesen e madhe te puneve qe linden nga ajo emergjence. Kane patur suport te vazhdueshem ne mjete, burime njerezore dhe karburant.

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Bashkia | SHIJAK | | | Kodi i Grupit / Njësisë Vendore | Organet ekzekutive dhe legjislative,Ceshtjet financiare.... | Realizimi ne % |
| Programi | 01110 | | | Kodi i Programit | 1110 | |
| Art. | Emertimi | Fakti i vitit paraardhes Viti 2019 | Buxheti Vjetor Plani i Periudhes/progresiv | Fakti i Periudhes/progresiv | Diferenca | |
| 600 | Paga | 27,678 | 40,797 | 39,856 | (941) | 98 |
| 601 | Sigurime Shoqërore | 5,084 | 6,692 | 6,691 | (1) | 100 |
| 602 | Mallra dhe Shërbime të Tjera | 23,468 | 30,213 | 22,919 | (7,294) | 76 |
| 603 | Subvencione | 2,000 | | | - | |
| 604 | Transferta Korente të Brendshme | | 6,385 | 3,765 | (2,620) | 59 |
| *Nen-Totali* | *Shpenzime Korrente* | *58,230* | *84,087* | *73,231* | *(10,856)* | 87 |
| **Totali (korrente + kapitale )** | | **69,873** | **84,087** | **73,231** | **(10,856)** | |

**Shërbim me kancelari dhe shtypshkrime** për administratën e Bashkisë së eshtë mundësuar sigurimi dhe furnizimi i vazhdueshëm me kancelari, letër, bojë, shtypshkrime etj për t'iu mundësuar punonjësve përmbushjen e detyrave administrative për të gjithë administratën.

**Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit** për funksionimin e administratës së Bashkisë së Shijak . Është realizuar furnizimi sistematik me karburant i mjeteve të transportit për kryerjen e detyrave dhe funksioneve të përditshme të administratës vendore të Bashkisë në qendër,njësi administrative etj.U realizua shërbimi i riparimit për të gjitha automjetet,shlyerja e të gjitha sigurimeve, taksave të qarkullimit dhe kolaudimit vjetor të mjeteve të transportit në shërbim të administratës .

Programi 03140 " Policia Vendore " ka keto tregues financiare

| Bashkia | SHIJAK | | | Kodi i Grupit / Njësisë Vendore | Policia Bashkiake |
|---|---|---|---|---|---|
| Programi | 03140 | | | Kodi i Programit | 031 |
| Art. | Emertimi | Fakti i vitit paraardhes Viti 2019 | Buxheti Vjetor Plani i Periudhes/progresiv | Fakti i Periudhes/progresiv | Diferenca |
| 600 | Paga | 5,343 | 4,549 | 4,239 | (310) |
| 601 | Sigurime Shoqërore | 757 | 784 | 654 | (130) |
| 602 | Mallra dhe Shërbime të Tjera | 1,575 | | | - |
| *Nen-Totali* | *Shpenzime Korrente* | *7,675* | *5,333* | *4,893* | *(440)* |

Është realizuar pajisja me uniforma për Policinë Bashkiake për vitin 2020, bazuar në ligjin 8224 ,date 15.05.1997 ”Për organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë dhe të komunës, i ndryshuar dhe VKM nr. 333 datë 02.06.1998 për “Miratimin e normës së veshmbathjes për policinë”, i ndryshuar, dhe urdherat në zbatim të këtij ligji ku përcaktohen qartë standartet dhe kriteret për normat e uniformave të policisë bashkiake. Gjithashtu ne mbeshtetje per kryerjen e funksionit te policise u eshte siguruar furnizimi me karburant dhe mirembajtje per mjetin e tyre.

Programi 03280 “Sherbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimi “
Shërbim i MZSH ka patur prioritet parandalimin e ngjarjeve. Është rritur numri dhe llojet e shërbimeve të sektorit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi, por struktura e ofrimit të shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi duhet te jete ne perputhje me standartet e kerkuara me ligj, ne pergjigje te te cilave ne kemi perdorur fonde nga te ardhurat e bashkise per te realizuar zbatimin e ketyre normave sic ishte dhe aplikimi per here te pare i sigurimit te jetes se zjarrfikesve, gje e cila eshte planifikuar edhe per vitet ne vazhdim .Shuma prej 1.588 mije lekesh jane fonde qe do te perdoren per kontraten e lidhur ne fund te vitit 2020 per veshjet speciale, dhe per pjese kembimi te automjeteve te ketij sherbimi. Ky sherbim i eshte pergjigjur 371 rasteve te shpetimit nga zjarri, sherbimeve ndaj familjeve te permbytura, si dhe mbeshtetja ne procesin e demolimit te pallateve te demtuara nga termeti i 26 nentorit 2019 .

ne 000/leke

| Bashkia | SHIJAK | | | Kodi i Grupit / Njësisë Vendore | Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpetimi. | Realizimi ne % |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Programi | 03280/ MZSH | | | Kodi i Programit | 032 | |
| Art. | Emertimi | Fakti | Buxheti Vjetor | Fakti | Diferenca | |

| | | i vitit paraardhes Viti 2019 | Plani i Periudhes/progresiv | i Periudhes/progresiv | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 600 | Paga | 7,923 | 10,690 | 10,690 | - | 100 |
| 601 | Sigurime Shoqërore | 1,477 | 1,633 | 1,633 | - | 100 |
| 602 | Mallra dhe Shërbime të Tjera | 1,520 | 3,044 | 1,456 | (1,588) | 48 |
| *Nen-Totali* | *Shpenzime Korrente* | *10,920* | *15,367* | *13,779* | *(1,588)* | 90 |

Programi 04240 "Bujqesia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia "eshte realizuar 85 % ose ne vlere -10,038 mije leke, nga keto kemi 7,254 mije leke investime te pakryera sic eshte objekti "Ndertimi I Shkarkuesve Katastrofike "per te cilin procedura e tenderimit ka deshtuar per vitin e kaluar ky fond per vleren 3,232 mije leke eshte celur perseri per vitin 2021, teprica nga fondet e Kanaleve Ujitese Hardhishte –Rreth per shumen 1,765 mije leke dhe 2,258 mije leke jane fondet qe trashegohen nga 4 vite rradhazi nga investimet ne kanalet kulluese te vitit 2017.Ndersa shuma e paperdorur ne zerin "Mallra dhe sherbime " jane kontrata per pjese kembimi te mjeteve te bujqesise apo karburant qe vazhdojne ne vitin 2021.

| **Bashkia** | **SHIJAK** | | **Kodi i Grupit / Njësisë Vendore** | Bujqesia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia | Realizimi ne % |
|---|---|---|---|---|---|
| **Programi** | 04240 | | **Kodi i Programit** | 04240 | |
| **Art.** | **Emertimi** | **Buxheti Vjetor**<br>**Plani i Periudhes/progresiv** | **Fakti**<br>**i**<br>**Periudhes/progresiv** | **Diferenca** | |
| 600 | Paga | 11,156 | 9,934 | (1,222) | 89 |
| 601 | Sigurime Shoqërore | 1,819 | 1,812 | (7) | 100 |
| 602 | Mallra dhe Shërbime të Tjera | 9,090 | 7,535 | (1,555) | 83 |
| *Nen-Totali* | *Shpenzime Korrente* | *22,065* | *19,281* | *(2,784)* | 87 |
| 231 | Kapitale të Trupëzuara | 43,718 | 36,464 | 7,254 | 83 |
| *Totali* | Shpenzime Kapitale | 43,718 | 36,464 | 7,254 | 83 |
| Totali (korrente + kapitale ) | | 65,783 | 55,745 | 10,038 | 85 |

Programi 04520 “ Transporti, ndertim dhe mirembajtje rrugesh “

Ne kete program kemi nje realizim ne masen 85 % ose 6,178 mije leke nga te cilat 1,516 mije leke jane kontrata sherbimi qe vazhdojne ne vitin 2021 dhe difernca prej 3,715 mije lekesh eshte fondi qe trashegohet nga ministria e linjes qe prej 4 vitesh pa te drejte perdorimi nga Bashkia nje ngerc ligjor qe nuk po sistemohet prej kaq kohesh dhe konkretisht kjo eshte teprice nga investimi ne objektin “Rehabilitimi ,sistemim asfaltim i Rruges Lagje Kokomaneve Nj.Ad Hardhishte “
Ne zerin e shpenzimeve operative kemi realizim te kontratave per blerje materiale ndertimi si cimento, rere , tuba betoni, pllaka,etj per riparime e mirembajtje te rrugeve e shesheve, stabilizant 816 mije leke ose 640 m3 stabilizant per sistemim te rrugeve rurale ne Nj.Ad Gjepalaj dhe Maminas, kontrata te realizuara pjeserisht ne vitin 2020 dhe vazhdojne ne vitin 2021 per blerje pjese kembimi per mjetet ne perdorim te sektorit te sherbimeve, etj

| Bashkia | SHIJAK | | | Kodi i Grupit / Njësisë Vendore | Transporti ndertim dhe mirembajtje rrugesh | Realizimi ne % |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Programi | 04520 | | | Kodi i Programit | 045 | |
| Art. | Emertimi | Fakti i vitit paraardhes Viti 2019 | Buxheti Vjetor Plani i Periudhes/progresiv | Fakti i Periudhes/progresiv | Diferenca | |
| 600 | Paga | 11,413 | 18,117 | 17,269 | (848) | 95 |
| 601 | Sigurime Shoqërore | 1,737 | 2,620 | 2,521 | (99) | 96 |
| 602 | Mallra dhe Shërbime të Tjera | 7,844 | 5,322 | 3,806 | (1,516) | 72 |
| *Nen-Totali* | *Shpenzime Korrente* | *20,994* | *26,059* | *23,596* | *(2,463)* | 91 |
| 231 | Kapitale të Trupëzuara | 12,698 | 16,395 | 12,680 | (3,715) | 77 |
| *Totali* | Shpenzime Kapitale | 12,698 | 16,395 | 12,680 | (3,715) | 77 |
| Totali (korrente + kapitale ) | | 33,692 | 42,454 | 36,276 | (6,178) | 85 |

Programi 05100 ” Menaxhimi I mbetjeve “ eshte realizuar ne masen 63 % ose -17,767 mije leke kjo diference eshte nga realizimi i lidhjes me 4 muaj vonese te kontrates se sipermarrjes per arsye te zgjidhjeve te antikapeve ligjore midis ministrive perkatese per zgjidhjen e problemit te vendit te grumbullimit te mbetjeve.

| Bashkia | SHIJAK | | | Kodi i Grupit / Njësisë Vendore | Menaxhimi I mbetjeve.... | Realizimi ne % |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Programi | 05100 | | | Kodi i Programit | 051 | |
| Art. | Emertimi | Fakti i vitit paraardhes Viti 2019 | Buxheti Vjetor Plani i Periudhes/ progresiv | Fakti i Periudhes/progresiv | Diferenca | |
| 600 | Paga | 3,460 | 1,100 | 1,100 | - | 100 |
| 601 | Sigurime Shoqërore | 481 | 176 | 176 | - | 100 |
| 602 | Mallra dhe Shërbime të Tjera | 39,295 | 46,920 | 29,153 | (17,767) | 62 |
| **Totali (korrente + kapitale )** | | **43,236** | **48,196** | **30,429** | 17,767 | 63 |

Programi 05200 ” Menaxhimi I Ujrave te Zeza “
Ne kete program per vitin 2020 kemi patur vetem vazhdimin e investimit per objektin “Ndertimi i Kanalit te Ujrave te Zeza Sallmone “Nj.Ad Xhafzotaj i cili sic shihet eshte realizuar per vleren e planifikuar ne vitin 2020.

| Bashkia | SHIJAK | | | Kodi i Grupit / Njësisë Vendore | Menaxhim i I ujerave te zeza | Realizimi ne % |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Programi | 05200 | | | Kodi i Programit | 052 | |
| Art. | Emertimi | Fakti i vitit paraardhes Viti 2019 | Buxheti Vjetor Plani i Periudhes/progresiv | Fakti i Periudhes/progresiv | Diferenca | |
| 602 | Mallra dhe Shërbime të Tjera | 400 | | | - | |
| ***Nen-Totali*** | ***Shpenzime Korrente*** | ***400*** | ***-*** | ***-*** | ***-*** | |
| 231 | Kapitale të Trupëzuara | 4,000 | | | - | |
| ***Nen -Totali*** | ***Shpenzime Kapitale me financim te brendshem*** | ***4,000*** | ***-*** | ***-*** | ***-*** | |
| 231 | Kapitale të Trupëzuara | | ***28,324*** | ***27,685*** | (639) | 98 |
| **Totali (korrente + kapitale )** | | **4,400** | **28,324** | **27,685** | **(639)** | 98 |

Programi 06260 “Sherbimet Publike Vendore “

Ne kete program per vitin 2020 kemi investimin me objekt “Hapesire rekreative, parku tek ish shkolla Muharrem Dollaku “ i cili sic shihet eshte realizuar ne detyrimin per vitin ne masen 95 % dhe diferenca per mbyllje perfundimtare eshte vetem per 754 mije leke qe eshte planifikuar ne vitin 2021.

| Bashkia | SHIJAK | | | Kodi i Grupit / Njësisë Vendore | Sherbimet publike vendore | Realizimi ne % |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Programi | 06260 | | | Kodi i Programit | 062 | |
| Art. | Emertimi | Fakti i vitit paraardhes Viti 2019 | Buxheti Vjetor Plani i Periudhes/progresiv | Fakti i Periudhes/progresiv | Diferenca | |
| 602 | Mallra dhe Shërbime të Tjera | 858 | | | - | |
| *Nen-Totali* | *Shpenzime Korrente* | *858* | - | - | - | |
| 231 | Kapitale të Trupëzuara | 26,466 | 34,644 | 32,858 | (1,786) | 95 |
| *Totali* | Shpenzime Kapitale | 26,466 | 34,644 | 32,858 | (1,786) | 95 |
| Totali (korrente + kapitale ) | | 27,324 | 34,644 | 32,858 | (1,786) | 95 |

Ne programin 06440 “Ndricimi i rrugeve“ per vitin 2020 ane perballuar me se miri shpenzimet per Energjine Elektrike fale nje pune te mire ne menaxhimin e ketij sektori jane shpenzuar 15,278 mije leke nga 30.000 te planifikuara per kete sherbim.

Programi 08130 “Sherbimet Rekreative dhe Sportet “ky program mbulon organizimin e përvitshëm i aktiviteteve sportive dhe zhvillimi i sportit në komunitet. Nepermjet programit për rininë dhe sportin mbështeten administrimi dhe funksionimi i Klubit Volejbollit “Erzeni” dhe Klubi i futbollit “Erzeni”
Shpenzimet operative te cilat jane realizuar ne masen 71 % jane detyrimet per honorare te te dy ekipeve per muajin dhjetor per shumen 1,920 mije leke , si dhe per vitin 2020 nuk u realizua kontrata per transportin e sportisteve per shumen 1,400 mije leke,kontrata per blerjen e veshjeve sportive per shumen 1,000 mije leke.

| Bashkia | SHIJAK | | | Kodi i Grupit / Njësisë Vendore | Sherbimet Rekreative dhe Sportet.... | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Programi | 08130 | | | Kodi i Programit | 081 | |
| Art. | Emertimi | Fakti i vitit paraardhes Viti 2019 | Buxheti Vjetor Plani i Periudhes/progresiv | Fakti i Periudhes/progresiv | Diferenca | |
| 600 | Paga | 2,960 | 3,146 | 2,916 | (230) | 93 |
| 601 | Sigurime Shoqërore | 600 | 506 | 506 | - | 100 |
| 602 | Mallra dhe Shërbime të Tjera | 23,262 | 25,522 | 18,042 | (7,480) | 71 |
| *Nen-Totali* | *Shpenzime Korrente* | *26,822* | *29,174* | *21,464* | *(7,710)* | 74 |
| Totali (korrente + kapitale ) | | 26,822 | 29,174 | 21,464 | (7,710) | 74 |

Programi 08220 “Sherbimet Kulturore “ Gjate 2020 Këshilli Artistiko Kulturor i Bashkise Shijak i përbëre prej 3 anëtarësh funksionoi rregullisht. Ai mori në shqyrtim në bazë të një proçedure të parashikuar në ligj, 2 projektet kulturore, Projekti “Veshtrim ne Vite “ organizuar ne sheshin kryesor te qytetit per shumen 215 mije leke, dhe projekti “Tirana 100 Vjet Kryeqytet “ per shumen 128 mije leke, te paraqitura para ketij keshilli per vendim marrje.Ne kete program realizohen edhe shpenzimet per deokrimin e qytetit per festa dhe fund vit te cilat kapin shumen 800 mije lekeve etj.

| Bashkia | SHIJAK | | | Kodi i Grupit / Njësisë Vendore | Sherbimet Kulturore. | Realizimi ne % |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Programi | 08220 | | | Kodi i Programit | 082 | |
| Art. | Emertimi | -1 Fakti i vitit paraardhes Viti 2019 | -5 Buxheti Vjetor Plani i Periudhes/progresiv | -6 Fakti i Periudhes/progresiv | (7)=(6)-(5) Diferenca | |
| 600 | Paga | 790 | 1,419 | 1,418 | (1) | 100 |
| 601 | Sigurime Shoqërore | 100 | 231 | 189 | (42) | 82 |
| 602 | Mallra dhe Shërbime të Tjera | 2,049 | 2,400 | 1,221 | (1,179) | 51 |
| *Nen-Totali* | *Shpenzime Korrente* | *2,939* | *4,050* | *2,828* | *(1,222)* | 70 |

Programi 09120 " Arsimi baze dhe parashkollor " eshte realizuar ne total ne masen 82 % dhe shpenzimet operative per kete vit jane realizuar ne masen 27 % pasi sic kemi miratuar edhe ketu ne keshill gjate vitit 2020 u shemben 5 institucione arsimore dhe 1 kopeshti per te cilat kane qene planifikuar sherbime te mirembajtjes , lyerje te cilat ne kushte te tilla nuk do te realizoheshin , ndersa fakti i shpenzimeve tregon fatura te likujdimev per energji elektrike, blerje materiale pastrimi ,gaz e dru zjarri per ngrohje, kancelari dhe blerje tonerash per printera e fotokopje te institucioneve.

Gjate gjithe vitit eshte ofruar sherbim mirembajtjeje per shkollat e te gjithe bashkise.

Programi eshte synuar menaxhim me efikasitet i fondeve për Arsimin dhe krijimi i mundësive për zhvillim normal te punes ne institucionet arsimore në të gjithë territorin e Bashkisë Shijak.

Diferenca ne zerin e investimeve per shumen e 8,010 mije lekeve eshte detyrimi per pjesemarrjen e bashkise ne investim te shkolles "Muharrem Dollaku" dhe " Adem Sabli " per mos arritje te mbylljes se procedurave ne afat.

Kane perfunduar keto investime

1* Ndertimi ".Shkolles 9 vjecare Adem Sabli ne fshatin Borake te Nj.Ad Xhafzotaj me fonde te Buxhetit te shtetit dhe pjesemarrje te Bashkise per 10 % te fondit te ndertimit .

2* Ndertimi i Shkolles se Mesme 16 Shtatori ne Shijak me Grantet e Rindertimit

3* Ndertimi i shkollese se Mesme Kajo Karafili " ne Maminas Nj.Ad Maminas me Grantet e Rindertimit

4*Ndertimi i Kopeshtit Nr 1 ne qytetin e Shijakut me Grantet e Rindertimit

Sic dihet jane ne proces Rindertimi 2 shkollat 9- vjecare ne qytetin e Shijakut" Lidhja e Prizerenit "dhe" Petrit Llaftiu "me Grantet e Rindertimit.

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Bashkia** | **SHIJAK** | | | **Kodi i Grupit / Njësisë Vendore** | Arsimi baze dhe parashkollor | Realizimi ne % |
| **Programi** | 09120 | | | **Kodi i Programit** | 091 | |
| **Art.** | **Emertimi** | **Fakti i vitit paraardhes Viti 2019** | **Buxheti Vjetor Plani i Periudhes/progresiv** | **Fakti i Periudhes/progresiv** | **Diferenca** | |
| 600 | Paga | 43,562 | 42,706 | 40,661 | (2,045) | 95 |
| 601 | Sigurime Shoqërore | 7,290 | 7,343 | 7,298 | (45) | 99 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 602 | Mallra dhe Shërbime të Tjera | 16,845 | 16,091 | 4,383 | (11,708) | 27 |
| *Nen-Totali* | *Shpenzime Korrente* | *67,697* | *66,140* | *52,342* | *(13,798)* | 79 |
| 231 | Kapitale të Trupëzuara | 63,009 | 53,605 | 45,595 | (8,010) | 85 |
| *Totali* | **Shpenzime Kapitale** | **63,009** | **53,605** | **45,595** | **(8,010)** | 85 |
| **Totali (korrente + kapitale )** | | **130,706** | **119,745** | **97,937** | **(21,808)** | 82 |

Programi 10430 “Familja dhe Femijet “ Administrimi dhe funksionimi i Çerdheve.

Ne kete program jane realizuar shpenzimet 94 % ne te cilat jane pagat dhe sig shoqerore te 12 punonjesve .
Është realizuar vlerësimi i nevojave për ndërhyrje me qëllim krijimin e kushteve sa më të favorshme për foshnjet që frekuentojnë çerdhe duke sistemuar femijet e kesaj kategorie ne nje ndertese te re te ndertuar nga donator. Numri i femijeve që frekuentojnë këte çerdhe është 25-30.
Ne kete program perfshihet edhe aktiviteti i rregullt ne Qendren Komunitare e Rehabilitimit te Femijeve me Aftesi te Kufizuara ku gjate gjithe vitit aty trajnohen mesatarisht 14 femije me aftesi te kufizuara, ky aktivitet perballohet nga te ardhurat e bashkise sic jane shpenzimet e personelit prej 3 specialiste dhe 1 punonjes sherbimi dhe shpenzime te mirembajtjes dhe te pastrimit per kete ndertes.Shpenzimet per paga dhe sig per te dy aktivitet kapin shumen 6,164 mije leke lekesh.

| **Bashkia** | **SHIJAK** | | | **Kodi i Grupit / Njësisë Vendore** | Familja dhe femijet | Realizimi ne % |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Programi** | 10430 | | | **Kodi i Programit** | 10430 | |
| **Art.** | **Emertimi** | **Fakti i vitit paraardhes Viti 2019** | **Buxheti Vjetor Plani i Periudhes/progresiv** | **Fakti i Periudhes/progresiv** | **Diferenca** | |
| 600 | Paga | 4,128 | 5,643 | 5,266 | (377) | 93.32 |
| 601 | Sigurime Shoqërore | 820 | 898 | 898 | - | 100.00 |
| 602 | Mallra dhe Shërbime të Tjera | 188 | | | - | |
| *Nen-Totali* | *Shpenzime Korrente* | *5,136* | *6,541* | *6,164* | *(377)* | 94.24 |
| 231 | Kapitale të Trupëzuara | 804 | | | - | |
| **Totali (korrente + kapitale )** | | **5,940** | **6,541** | **6,164** | **(377)** | 94.24 |

Programi 10660 " Strehimi Social "

Ne kete program realizojme sherbimin e mbeshtetjes se 12 familjeve te pastrehe ne qytetin tone sidomos shtreses per Komunitetin Rom, te cileve u jane siguruar ambjente me qera, te cilat paguhen nga Bashkia Shijak. Shuma prej 460 mije lekesh eshte paguar ne janar te vitit 2021 pasi duhej te mbylleshin rinovimet e kontratave me qiradhenesit.

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Bashkia | SHIJAK | | | Kodi i Grupit / Njësisë Vendore | Strehim Social | Realizimi ne % |
| Programi | 10660 | | | Kodi i Programit | 106 | |
| Art. | Emertimi | -1 Fakti i vitit paraardhes Viti 2019 | -5 Buxheti Vjetor Plani i Periudhes/progresiv | -6 Fakti i Periudhes/progresiv | (7)=(6)-(5) Diferenca | |
| 602 | Mallra dhe Shërbime të Tjera | 1,260 | 1,360 | 900 | (460) | 66 |
| *Nen-Totali* | *Shpenzime Korrente* | *1,260* | *1,360* | *900* | *(460)* | 66 |

Tabela e meposhteme Aneksi nr 3 liston investimet e realizuara ne vitin 2020.

## ANEKSI nr.3 "Projektet e investimeve me financim te brendshem"

**Projektet me financim te brendshëm (ne 000/leke)**

| Kodi projektit | Emertimi i projektit | Vlera e plotë projektit | Viti i fillimit projektit | Viti i përfundimit projektit | | Plani i buxhetit viti 2020 | REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i vitit deri në periudhën aktuale | REALIZIMI për periudhën e raportimit (/vjetore) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 18BC887 | Ndertimi I Shkolles Adem Sabli | 71,982 | 2,019 | 2,020 | | 50,698 | 44,887 | 88.54 |
| M112755 | Ndertim I Shkolles Muharrem Dollaku | 78,584 | 2,019 | 2,020 | | 2,908 | 708 | 24.35 |
| 1080156 | Ambient Shlodhes Parku tek ish Shkolla " Muharrem Dollaku" | 40,167 | 2,019 | 2,020 | | 34,644 | 32,858 | 94.84 |
| 1080155 | Ndertim I Kanalit Ujrave te Zeza Kuz Sallmone | 51,437 | 2,019 | 2,021 | | 28,324 | 27,685 | 97.74 |
| 18AJ920 | Rehab Kanali Kullues Hardhishte | | 2,019 | 2,020 | | 38,230 | 36,465 | 95.38 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Rreth | 62,148 | | | | | | |
| 18BQ390 | Ndertimi I Rrjetit Ujsjellsit ne Bashkine Shijak | 331,620 | 2,020 | 2,022 | | 70,865 | 70,865 | 100.00 |
| 18CC401 | Ndertim rrjetit te kanalizimeve Segmenti 4 rruget Shijak Ura e Dajlanit " | 6,545 | 2,020 | 2,021 | | | | Procedure e deshtuar 2 here |
| | Rehabilitim KUZ, Lagjia Begtesh, Njesia Ad. Gjepalaj | 3,188 | 2,020 | 2,021 | | 3,188 | | eshte lidhur kontrata |
| 1080176 | Rikualifikimi rruges Ish SMT deri te Shala Group dhe ndertimi I rrjetit KUZ ne Rrugen " Xhelal Memoci " | 99,924 | 2,020 | 2,022 | | 12,680 | 12,680 | 100.00 |
| | Ndertim I Shkarkuesve Katastrofike | 3,232 | 2,020 | 2,021 | | 3,232 | | eshte lidhur kontrata |
| | | **673,613** | | | | **244,769** | **226,148** | 92.39 |

Sic shihet ne total investimet jane realizuar ne masen 92 % dhe ne vlere leku kemi nje diference ne shumen minus 18,621 mije leke kjo shume perbehet nga 2 projektet per te cilat sapo eshte lidhur kontrata dhe nga projekti per proceduren e deshtuar.Diferenca e projektit per shkollen Muharrem Dollaku eshte planifikuar me te ardhurat qe do trashegojme pasi ishte detyrim i vitit te kaluar.

Sic shihet investime te parealizuara nga buxheti i vitit 2020 jane

1.Shpronesim toke per varreza te reja ne qytetin e shijakut , ky fond eshte trasheguar per tu realizuar ne buxhetin e vitit 2021.

2.Investimi i Rehabilitimin e Hapesire Rekreative Parku i qytetit Shijak pa perfunduar punimet , edhe ky fond eshte trasheguar me te njejtin destinacion.

3.Ndertimi i KUZ Sallmone Nj.Ad Xhafzotaj pa perfunduar punimet , edhe ky fond eshte trasheguar me te njejtin destinacion.

4.Rindertimi i shkolles 9 vjecare Muharrem Dollaku i pa likujduar per shumen e punimeve e paperfunduara dhe fondi eshte trasheguar me te njejtin destinacion.

**Auditimi I veprimtarise financiare te Bashkise Shijak**

Gjate vitit 2020 Bashkia Shijak nuk ka patur auditime nga autoriteti i KLSH apo nga auditi i brendshem,por ka vazhduar puna per realizimin e detyrave te lena nga audituesit e KLSH nga viti 2018.

DETYRIMET E PRAPAMBETURA NGA VITI  2020

Bashkia  Shijak ne fund te vitit 2020 ne llogarine 486 per detyrime te prapambetura ka te rregjistruar shumen 9,593,912 leke, dhe ky detyrim i perket projektit Ndertimi i KUZ Sallmone per diferencen e fatures me nr 370 date 31.12.2019.

## Detyrimet ndaj të tretëve sipas vjetërsisë së tyre, situata financiar normale dhe rastet e vështirësive financiare

**Muaji  Dhjetor 2020**

| N.R | Emërtimi | Stoku në vlerë | Totali i shpenzimeve të miratuara për NJVQV-në | Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJQV-së |
|---|---|---|---|---|
| **I** | **Borxhe (a+b)** | **0** | | |
| **a** | **Hua sfatgjatë** | **0** | | |
| **b** | **Hua afatshkurtër** | **0** | | |
| **II** | **Detyrime (a+b+c)** | **9,593,912** | | **1.52%** |
| **a** | **Shpenzime korrente** | **0** | | |
| **b** | **Shenzime kapitale** | **9,593,912** | | |
| b,2 | Subjekte private | 9,593,912 | | |
| **c** | **Vendime gjyqësore** | **0** | | |
| **III** | **Totali (I+II)** | **9,593,912** | **632,032,260** | **1.52%** |

| Rasti i vështirësisë ku ndodhet njësia e vetëqeverisjes vendore | | | |
|---|---|---|---|
| | **Probleme financiare** | **Vështirësi financiare** | **V** |
| Situata Normale e gjendjes fiannciare | Stoku i detyrimeve/Shpenzime > 15% | Stoku i detyrimeve/Shpenzime > 25% | dety |
| **Situat Normale e gjendjes financiare** | **0** | **0** | |

Me keto te dhena  Bashkia Shijak nuk rezulton me  veshtiresi financiare , tregues domethenes per miremenaxhim te fondeve te Bashkise.

Rezultati financiar i Bashkia Shijak per vitin 2020 rezulton me 558,901,499.02 leke gjendje ne llogarine e thesari si celje per vitin 2021, nga te cilat  465,541,574 leke  jane grante  rindertimi dhe 93,359,925.02 leke jane te ardhura per tu detajuar per kryerjen e funksioneve te bashkise .Kjo shume tashme do te detajohet meVendimin e Keshillit Bashkiak  me object “Shtese  Buxheti per vitin 2021”.

**Drejtori Ekonomik**

**Pranvera Alushi**